



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1525 Prot.

Tiranë, më datë 12.12.2023

**VENDIM**  
**Nr. 601, datë 12.12.2023**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saf”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.12.2023:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks banimi 2-3 kat me 1 kat pjesërisht nëntokë me mur rrethues”, Njësia Administrative Farkë”, me vendndodhje Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar z. Elio Hobdari, **me zhvillues Bevea Group**;
2. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 145 - 147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Klesta QIRICI**

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

